



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

**STRATEGJIA SHITETËRORE PËR ZVOGËLIMIN E RREZIKUT NGA
FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA**

2023 - 2028

Data: 26/10/2022

Përmbajtja

1. Hyrje
 - 1.1** Qëllimi
 - 1.2** Vizioni
2. Metodologjia
3. Parimet e përgjithshme
4. Analiza e situatës aktuale
 - 4.1. Historiku
 - 4.2. Situata aktuale
 - 4.3. Rreziqet që kërcënojnë Republikën e Kosovës
 - 4.4. Përshkrimi i disa rreziqeve me prioritet
 - 4.5. Cenueshmëria dhe kapaciteti
 - 4.6. Statusi (gjendja) e nismave për zvogëlimin e rrezikut
 - 4.7. Analiza SWOT
5. Korniza ligjore dhe mekanizmat institucional
 - 5.1** Korniza ligjore
 - 5.2** Mekanizmi institucional
6. Objektivat strategjike për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera
 - 6.1** Sfondi
 - 6.2** Objektivat strategjike
 - 6.3** Drejtuesit strategjik dhe iniciativat për të mbështetur objektivat specifik
 - 6.4** Parimet/principet që udhëzojnë për nismat e mësipërme
 - 6.5** Mjetet për zbatimin e Strategjisë
 - 6.6** Marrëveshjet për kapacitete të integruara institucionale për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë
 - 6.7** Zbutja dhe parandalimi i fatkeqësive
 - 6.8** Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë përmes reagimit efektiv, rimëkëmbjes dhe rindërtimit

6.9 Integrimi dhe mobilizimi efektiv i njohurive të autoriteteve tradicionale, grave dhe fëmijëve, si dhe grupeve të marginalizuara

6.1.1 Menaxhimi i informacionit dhe komunikimi

6.1.2 Aspektet e mëposhtme që duhet të merren parasysh nga perspektiva e komunikimit për të mbështetur fokusin e kësaj mundësie

6.1.3 Mobilizimi dhe fondet

7. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi i Strategjisë

7.1 Direktivat e zbatimit strategjik dhe prioritetet për ndryshimin strategjik

7.2 Roli i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit

7.3 Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

7.4 Indikatorët për monitorim dhe vlerësim

7.5 Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

8. Plani i Veprimit

Lista e shkurtesave

AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DPPA	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
MM	Ministria e Mbrojtjes
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IPA	Instrumenti i Para Aksesimit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
ME	Ministria e Ekonomisë
MKK	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
NJPZSH	Njësitë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

PLANAT	Platforma Kombëtare për Fatkeqësitë Natyrore
SFA	Korniza e Senday-it për Veprim
SIME	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent
SMSHN	Strukturat për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Emergjencës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNISDR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRrF	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (në tekstin e mëtejme fatkeqësitë) dhe Plani i Veprimit 2023-2028, është dokumenti i dytë i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ka për qëllim zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Është e qartë se fatkeqësitë mund të kenë ndikim të konsiderueshëm negativ në njerëz dhe në ekonomi dhe se zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë duhet të jetë prioritet shtetëror. Natyra, përhapja dhe kostoja e fatkeqësive kërkojnë përfshirjen e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në nivel qendror dhe lokal. Strategjitë dhe aktivitetet për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë kontribuojnë në uljen e rrezikut nga fatkeqësitë dhe ndikimet negative të tyre, si dhe arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbutjen e varfërisë, përmes lehtësimit të integritimit të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në zhvillim dhe vendimmarrje efikase dhe efektive.

Ky dokument strategjik ka për qëllim zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe të shërbej si kornizë për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel vendi, përmes aktiviteteve që do të planifikohen dhe zbatohen nga Institucionet e Republikës së Kosovës.

Strategjia bazohet në pesë shtylla apo objektiva strategjike të cilat janë në harmoni të plotë me dokumentet tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

1. Hyrje

Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2023-2028, është dokument strategjik i cili përcakton politikat dhe masat që ndërmerren për zvogëlimin e rrezikut kundër fatkeqësive në Kosovë. Fatkeqësitë në Kosovë përbëjnë një rrezik për jetën, të mirat materiale, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin në përgjithësi. Në fakt në tërësi procesi i zhvillimit ekonomik dhe social i vendit është i cenuar nga rreziqet e fatkeqësive, të cilat shpesh i kushtojnë miliona euro ekonomisë, si dhe në veçanti prekin komunitetet në nevojë. Duke qenë një shtet i ri, Kosova ende nuk ka ngritur kapacitete të plota për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent. Kjo strategji që përfshin periudhën 2023 - 2028 është një dokument themelor që ka për qëllim të bashkërendojë punën nga institucionet në nivel lokal, ministritë e linjës, sektorit privat, shoqërisë civile, OJQ-ve si dhe donatorët vendor dhe të huaj, për të zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë dhe njëkohësisht duke kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm të Kosovës. Ky dokument do të shërbejë si bazë për zvogëlimin e rrezikut për Republikën e Kosovës dhe si i tillë shërben si themel mbi të cilin do të hartohen programe dhe plane për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe do të bashkërendohen aktivitetet për vite me radhë.

Objektivat strategjike dhe ato specifike janë përcaktuar pas një procesi të konsultimit me të gjithë përfaqësuesit institucional për zvogëlimin e rrezikut dhe përfaqësuesve të tjerë të jashtëm si shoqëria civile, bota akademike dhe partnerët ndërkombëtarë. Strategjia gjithashtu është bazuar në analizat paraprake të realizuara në bashkëpunim me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë.

Në Strategjinë Shtetërore për Zvogëlimin Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023-2028, rekomandohen veprime dhe masa konkrete me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuara dhe përmirësimit të gjendjes në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Në këtë drejtim, janë paraparë veprime në funksion të përmirësimit të mekanizmit kombëtar, të zbatimit të veprimeve të koordinuara për zvogëlimin e rrezikut dhe fuqizimit të bashkëpunimit qendror dhe lokal deri në komunitet dhe familje.

Të gjitha këto veprime janë rekomanduar si rezultat i vlerësimit të situatës aktuale në vend dhe në kontekst vendor, rajonal e global në raport me zvogëlimin e rrezikut, i rezultateve të analizave gjithëpërfshirëse të dokumenteve ligjore, nënligjore dhe analizave tjera empirike të dala nga hulumtimet e ndryshme të realizuara gjatë viteve të kaluara. Rrjedhimisht, adresimi i veprimeve të rekomanduara pritet të ketë ndikim pozitiv në adresimin e boshllëqeve të identifikuara në sistem, duke mundësuar njëkohësisht avancimin dhe fuqizimin e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Plani i Veprimit është hartuar në përputhje me objektivat strategjike, objektivat specifike dhe aktivitetet e planifikuara që ndihmojnë në përmbushjen e objektivave specifike drejt arritjes së objektivave strategjike.

1.1 Qëllimi

Orientimi i politikave dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, me qëllim të minimizimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në masë sa më të vogël që është e mundur.

1.2 Vizioni

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë duke i parandaluar rreziqet e reja, duke i zvogëluar rreziqet ekzistuese, si dhe duke e menaxhuar rrezikun e mbetur nga fatkeqësitë në Republikën e Kosovës.

2. Metodologjia

Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, si dhe Plani i Veprimit 2023-2028 është hartuar në mbështetje të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2022 dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, viti 2021-2023.

Strategjia është në harmoni të plotë me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2018 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë e Përgatitjes dhe Miratimit të Dokumenteve Strategjike dhe Planeve për Zbatimin e Tyre, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Grupi punues për hartimin e strategjisë është formuar nga Sekretari i Përhershëm i MPB-së me Vendimin Nr. 300/22, më 25.02.2022 për hartimin e Strategjisë për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë, në të cilën janë përfshirë të gjitha institucionet përkatëse shtetërore, ndërsa në cilësinë e ekspertit janë përfshirë edhe përfaqësues nga OSBE-ja. Duke synuar një qasje shumë disiplinore për zvogëlimin e rrezikut dhe integrimin e këtyre fenomeneve në politikat dhe planet zhvillimore në vend, grupi punues ka pasur takime në baza mujore për mbikëqyrjen e progresit dhe planifikimin e hapave të mëtejme. Janë bërë konsultime edhe me ministrinë dhe institucionet tjera përkatëse të cilat nuk janë anëtare të grupit punues, në mënyrë që strategjia të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe kuptimplotë.

Grupi i ekspertëve gjithnjë, në faza të ndryshme të zhvillimit të strategjisë ka ofruar këshilla për përmbajtjen e strategjisë. Së fundmi, disa fenomene sikurse janë ndryshimet klimatike, jonizimi dhe vërshimet nuk trajtohen ose trajtohen më pak në këtë strategji, pasi këto mbulohen nga strategjitë përkatëse sektoriale.

Hartimi i Strategjisë për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (ZRrF) i ka paraprirë baza ligjore e cila gjendet në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit dhe Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, të hartuar në bazë të Rregullores Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

Strategjia për ZRRF 2023 – 2028 është në harmoni edhe me dokumentet tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, siç janë: Strategjia për Siguri, Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (SIME), Strategjia për Ndryshime Klimatike 2014-2020, Synimet e Qëndrueshme për Zhvillim, të përcaktuara sipas Kombeve të Bashkuara dhe në kuadër të Kornizës HYOGO dhe SENDAY-it për Veprim për vitet 2015-2030, zhvillimi i qëndrueshmërisë kombëtare dhe komuniteti në fatkeqësi, etj. Përveç tyre me rastin e ndërtimit të Strategjisë Shtetërore, është marrë në konsideratë edhe Strategjia e Bashkimit Evropian për Sigurinë e Brendshme dhe Strategjia Evropiane për mbështetje në zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë e vendeve në zhvillim. Strategjia për ZRRF shërben edhe si udhërrëfyes i Kosovës për anëtarësim në "Forumit Evropian për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë".

Procesi i hartimit të strategjisë është koordinuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Grupi punues i përbërë edhe nga ministratë tjera, janë përfshirë në vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të hollësishëm në analizimin e gjendjes aktuale, identifikimin e sfidave për tu adresuar me këtë strategji dhe duke propozuar objektiva dhe masa të cilat do të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve të përfshira në zbatim me qëllim të zvogëlimin të rrezikut, gjithmonë duke qenë të vetëdijshëm për aspektin e dëmeve në jetë njerëzish, të mira materiale, infrastrukturë, trashëgimi kulturore dhe mjedis që shkaktojnë fatkeqësitë. Përgjatë takimeve janë diskutuar dhe dhënë vlerësime për gjendjen aktuale në fushën e menaxhimit të rrezikut, me ç' rast janë propozuar aktivitetet që e ndihmojnë arritjen e objektivave specifike dhe realizimin e atyre strategjike, duke propozuar përmirësime me përqendrim në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Qasja ka qenë shumë disiplinore, pro aktive si dhe në grupe punuese me përfaqësues institucional, pjesëmarrjen aktive të shoqërisë civile në adresimin e nevojave për zvogëlimin e rrezikut, duke garantuar edhe ndjesinë e pronësisë së këtij dokumenti strategjik.

Përcaktimi i objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteteve është bazuar në të dhënat, të gjeturat dhe rekomandimet nga procesi i vlerësimit të gjendjes aktuale si dhe të dhënave paraprake të nxjerra nga platforma DeSinventar, historiku i fatkeqësive në Kosovë dhe raporteve të palëve vendore dhe ndërkombëtare, mirëpo edhe në identifikimin e këtyre prioriteteve dhe përcaktimin e objektivave në përputhje me prioritetet e qeverisë, si dhe situatën aktuale në Kosovë të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Koordinimi i hartimit të kësaj strategjie i takon MPB/AME. Parimet dhe përgjegjësitë e përfshira në këtë dokument drejtojnë zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në të gjithë vendin. Duke qenë se kjo është një strategji shtetërore, fillimisht do të hartohet një Plan Shtetëror për zvogëlimin e rrezikut, si dhe çdo institucion do të hartojë planin e tij të zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë, unike për fushën e tyre të veprimit. Fuqia dhe mundësia për zvogëlimin e qëndrueshëm të rrezikut nga fatkeqësitë varet nga përkushtimi i zyrtarëve udhëheqës dhe të mbështetur nga qeveria.

3. Parimet e përgjithshme

Struktura dhe përmbajtja e këtij dokumenti bazohet në këto parime:

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë - veprimet e ndërmarra për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjisllacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Parimi i qasjes gjithëpërfshirëse shtetërore – parandalimi dhe zvogëlimi i kërcënimeve nga fatkeqësitë arrihet përmes përfshirjes dhe bashkëpunimit të ngushtë në mes të institucioneve qeveritare, publike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare.

Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut – nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe zvogëlimin e fatkeqësive.

Parimi i konfidencialitetit – institucionet me përgjegjësi në parandalimin dhe zvogëlimin e fatkeqësive, duhet të sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informatave të shkruara dhe jo të shkruara të shkëmbyera mes institucioneve përkatëse.

Parimi i bashkëpunimit – Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në respektimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve midis institucioneve vendore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve dhe pasojave nga fatkeqësitë.

Parimi i besueshmërisë – institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve dhe pasojave nga fatkeqësitë, duhet ta kenë prioritet ndërtimin e mirëbesimit në ruajtjen e të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.

Parimi i proporcionalitetit – nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve që merren me parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve dhe pasojave nga fatkeqësitë, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme, në kohë reale dhe sa më të shkurtër të mundshme.

Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar – parandalimi dhe zvogëlimi i fatkeqësive arrihet përmes bashkëpunimit ndërkombëtar me shtete, organizata dhe iniciativa. Përmes bashkëpunimit, Republika e Kosovës do të ketë rol qenësor në parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve dhe pasojave nga fatkeqësitë.

4. Analiza e gjendjes aktuale


4.1 Historiku

Përpjekja për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në Kosovë sikurse edhe në botë, është një problem i cili është përkeqësuar në 20 vitet e fundit të tranzicionit, kjo për shkak të fenomenit të ndryshimeve klimatike, industrializimit të vendit, dëmeve të shkaktuara nga lufta, vendbanimet joformale, mungesën e planeve dhe moszbatimi i masave për ruajtjen

e mjedisit, degradimi i pyjeve dhe shtretërve të lumenjve dhe deponimit pa kritere të mbeturinave. Duke u bazuar në statistikat e dhëna nga platforma DesInventar, numri i fatkeqësive ka shënuar një trend në rritje ndër vite në periudhën 1999-2019, duke filluar me pasqyrimin e zjarreve pyjore, vërshimeve, tërmeteve, rrëshqitjeve të dheut, ortekët, rreziqet biologjike, si dhe sëmundjet ngjitëse, epidemitë, pandemitë, me theks të veçantë ajo e Krime Kongo-së.


Në vijim jepet pasqyra e historikut të fatkeqësive në Kosovë ndër vite.

Trendet kohore te zjarreve pyjore ne periudhen 1999-2019




Diagrami 1. Trendët kohore të zjarreve pyjore në periudhën 1999-2019.


Trendet kohore te vërshimeve dhe vërshimet e shpejta per periudhen 1999-2019



Diagrami 2. Trendët kohore të vërshimeve dhe vërshimeve të shpejta për periudhën 1999-2019.




Diagrami 3: Trendët kohore për rrëshqitjet e dheut, periudha kohore: 1999-2021.



Diagrami 4: Historiku i ngjarjeve Sizmike për periudhën 1921-2021 të paraqitura me Magnitudë, intensiteti është i ndryshueshëm për dekada, trendi ka një rritje dhe ulje të tërmeteve edhe në numër por edhe në madhësi (mag.) për dekada.

Demet ekonomike nga vershimet ne periudhen 1999-2019



Diagrami 5: Dëmet ekonomike (në Euro) nga vërshimet në periudhën kohore 2000-2019 sipas DesInventar Kosova.

Sa i përket kërcënimeve kryesore nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë nuk kanë ndryshuar ndjeshëm në pesë vitet e fundit. Gati gjysma e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë në vitet e fundit janë sëmundje me origjinë mjedisore, ushqimore, ujore ose zoonotike, pasuar nga sëmundjet që mund të parandalohen me vaksina. Rëndësi e veçantë për këto sëmundje është rreziku i përhapjes së shpejtë dhe shfaqjes në formë të epidemive, me mundësi të përhapjes ndërkuftare.

Kosova është dhe vazhdon të mbetet zonë endemike e sëmundjeve infektive që përhapen me ujë dhe ushqim. Në pesë vitet e fundit (2016 – 2020) në Kosovë janë regjistruar në total 9004 raste të sëmundjeve gastrointestinale të raportuara si diare akute. Viti 2019 ka shënuar numrin më të madh të rasteve (mbi 2394 raste). Moshat më të prekura janë ato të fëmijëve dhe moshat e reja, me mbi 70% të rasteve.

Republika e Kosovës është zonë endemike për zoonoza si bruceloza, tuberkulozi dhe tularemia.

Përveç sëmundjeve që regjistrohen në numër më të vogël apo më të madh çdo vit në territorin e Kosovës, ekziston mundësia e sjelljes së disa sëmundjeve nga jashtë. Kryesisht i referohemi sëmundjeve infektive jashtëzakonisht të rrezikshme që përhapen lehtësisht

dhe/ose kanë vdekshmëri të lartë - si kolera, SARS, gripi i shpezëve, ethet hemorragjike Krime Kongo, etj.

Me 30 janar 2020, drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së shpalli shpërthimin e korona virusit të ri Cov-2019, si një Emergjencë e Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare (PHEIC), bazuar në këshillat e Komitetit të Emergjencave në bazë të Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005). Rastet e para pozitive me virusin SARS CoV2 në Kosovë janë regjistruar me 13 mars 2020. Nga data 08.02.2020 deri më 09.08.2022, numri total i rasteve pozitive me COVID 19 është 263,784 (13.57%) nga 1,942,455 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2. Deri më 09.08.2022, 95.76 % e të infektuarve janë shëruar, ndërsa janë regjistruar gjithsej 3,180 raste të vdekjeve (shkalla e vdekshmërisë 1.20%). Përkundër suksesit të konsiderueshëm në vaksinimin e popullatës, ballafaqimi me pandeminë vazhdon edhe më tutje, me rritje të vazhdueshme të rasteve pozitive dhe mundësi reale të rritjes edhe të numrit të të vdekurve. Marrë parasysh situatën aktuale në botë dhe rajon, përfundimi i pandemisë është ende i pasigurt.

4.2 Gjendja aktuale

Popullsia prej 1.9 milion banorësh e Kosovës është e ekspozuar ndaj rreziqeve hidrometeorologjike dhe gjeologjike: zjarret, vërshimet, tërmetet, rrëshqitjet e dheut, reshjet e borës, ortekët, thatësia, erërat e forta (furtunat) endemitë, epidemitë, pandemitë, sëmundjet zoonotike dhe rreziqet KBRN (kimike, biologjike, radiologjike, nukleare).

Përmbytjet e shpejta janë të zakonshme në zonat malore, ndonjëherë duke çuar në rrëshqitjet e baltës.

Kosova është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrëshqitjeve të dheut, veçanërisht në Mitrovicë, Prishtinë, Pejë dhe Shtërpcë. Rreziqe të tjera që kërcënojnë Kosovën janë vërshimet e lumenjve (në rrafshje) dhe reshjet e reja (në Prishtinë, Mitrovicë, Besianë dhe Gjakovë, për shkak të cenueshmërisë strukturore të digave në këto zona). Në ndonjë lumë shumë të ekspozuar me pellgjet e tyre (si pellgu i Drinit, në pjesën perëndimore të vendit) vërshimet ndodhin çdo dy deri në tre vjet. Ndërmjet muajve Nëntor 2007 dhe Qershor 2008, tre vërshime shpërngulën 3500 njerëz, shkaktuan dëme në shtëpi dhe tokë bujqësore, dhe u kërkua ndihmë humanitare nga Bashkësia Ndërkombëtare. Luhatjet sezonale të reshjeve mund ta prekin rëndë prodhimin bujqësor në rajonet që varen nga reshjet për rritjen e kulturave dhe nuk kanë sistem alternativ ujitjeje. Kosova është përballur me thatësi disa herë në dy dekada (në 1993, 2000, 2007 dhe 2008). Në vitin 2000, thatësira mesatare deri në ato më të rënda prekën pjesën më të madhe të territorit të Kosovës. Që nga viti 2004, 80% e komunave të Kosovës në një kohë apo në një tjetër kanë vuajtur nga mungesa e ujit për shkak të sistemeve joefikase të menaxhimit të ujit (Save the Children 2018). Pyjet përbëjnë 43 për qind të territorit të Kosovës dhe janë veçanërisht të prekur ndaj zjarreve gjatë sezonit të thatë apo verës. Që nga viti 2000, numri i zjarreve në pyje është rritur, zjarrfikësit dhe ekipet e tjera reaguese përkatëse kanë kryer 2000 deri në 3000 ndërhyrje brenda një viti. Parashikohet që ekspozimi ndaj rreziqeve të tilla si thatësira, vërshimet dhe zjarret do të rriten me ndryshimin e klimës

dhe frekuencën më të madhe të klimës ekstreme.

Kosova gjeografikisht është në zonën e kontaktit të dy pllakave të mëdha tektonike, në një rën anë të Afrikës që shtyn Euro-Aziatiken dhe qëndron në themel të saj. Për këto arsye, vendet në zonën mesdhetare i përkasin vendeve me rrezik të lartë sizmik duke përfshirë edhe zonat përreth.

Tërmeti më i fortë i regjistruar dhe i dokumentuar në Kosovë është tërmeti i vitit 1921, në zonën Viti-Ferizaj- Gjilan me një magnitudë prej 6.1 në shkallën Richter dhe një intensitet prej 8.5 ballë Merkali. Zonat Sizmike (ZS) me rrezikun më të lartë në territorin e Kosovës janë: Zona Sizmogjene Istog-Pejë-Gjakovë, ZS Ferizaj-Viti-Gjilan, ZS Prizren-Dragash, këto janë zona që përshkohen edhe me thyerjet aktive që mund të shkaktojnë në të ardhmen tërmete me magnitudë maksimale 6.2-6.5 shkallë të Rihterit, kurse zonat me rrezik më të ulët, ZS Leposaviq, ZS Drenicë, dhe ZS Prishtinë-Mitrovicë, këto janë zonat që përshkohen edhe me thyerjet aktive që mund të shkaktojnë në të ardhmen tërmete me magnitudë maksimale 5.8-6.1 shkallë të Rihterit. (Sipas Hartës së rrezikut sizmik për territorin e Kosovës dhe Projekt Harmonizimit të rrezikut sizmik në Evropë).

Republika e Kosovës ka një trashëgimi kulturore të pasur që nga qytetërimet antike e deri më sot, që trashëgon një thesar të pasur kulturor, e cila është pjesë integrale e trashëgimisë kulturore botërore. Kjo trashëgimi e pasur, gjendet në çdo pjesë të Kosovës, në: parqet e qendrat arkeologjike e natyrore, në galeritë e artit, arkivat fotografike e filmike, në kalatë dhe kullat, në monumentet e kultit dhe vendbanime, në kalldrëmet e rrugicat e ngushta, në shatërvanët, si edhe në muzetë e saj, koleksione të artefakteve, punime artizanale, etj.

4.3 Rreziqet që kërcënojnë Republikën e Kosovës

4.3.1 Rreziqet natyrore

- Zjarret;
- Shtrëngatat;
- Vërshimet;
- Tërmetet;
- Rrokullisjet, shembjet e masave shkëmbore.

4.3.2 Rreziqet në ndërtesat teknike të ndjeshme – infrastruktura teknike

- Dëmtimet e digave.

4.3.3 Rreziqet gjatë transportit

- Transporti rrugor;
- Transporti hekurudhor;

- Transporti ajror;
- Transporti me materie të rrezikshme.

4.3.4 Rreziqet industriale

- Energjia;
- Aksidentet industriale;
- Mbetjet industriale dhe të rrezikshme.

4.3.5 Rreziqet epidemiologjike

- Helmimet me ujë;
- Sëmundjet zoonotike/transmisionive.

4.4 Analiza SWOT për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend

Janë identifikuar pikat e mëposhtme të forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet që kanë të bëjnë me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend. Këto pika të forta, të dobëta, mundësi dhe kërcënime ofrojnë një kuptim më të mirë të asaj që është arritur dhe ende duhet të arrihet në drejtim të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në vend.

PËRPARËSITË	MANGËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Agjencia e Menaxhimit Emergjent është agjenci ekzekutive dhe është tek Ministria e Punëve të Brendshme; • Ligje dhe rregullore që mbulojnë fushën e Menaxhimit Emergjent janë në fuqi; • Ekziston vlerësimi i rreziqeve në nivel vendi; • Është i aprovuar sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave; • Është i aprovuar Plani i Reagimit Kombëtar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka staf profesional për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë; • Republika e Kosovës nuk ka fonde emergjente; • Mos krijimi i Drejtorive për Mbrojtje dhe Shpëtim në nivel lokal; • Nuk ka ligj për sigurimet nga fatkeqësitë; • Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë nuk është mjaftueshëm i integruar në planet e zhvillimit; • Mungesa e gatishmërisë së mjaftueshme për fatkeqësitë në nivel komuniteti; • Mungesa e sistemit të alarmimit dhe komunikimit; • Mungesa e Sistemeve të Paralajmërimit të Hershëm (SPH). • Mungesa e memorandumeve me organizatat

	<p>qeveritare dhe jo qeveritare në lëmin e emergjencave civile;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e infrastrukturës për rezerva shtetërore.
KËRCËNIMET	MUNDËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Rreziqet në zhvillim si epidemitë dhe pandemitë; • Ndryshimet klimatike; • Mbështetja e financimit vendor në rënie; • Paqëndrueshmëri dhe rezistencë në disa komunitete për shkak të mungesës së informimit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi dhe plotësimi i ligjeve; • Kapaciteti për të krijuar partneritete; • Të mësuarit nga praktikatat e mira nga të tjerët për shkak të rritjes së rrezikut nga fatkeqësitë; • Krijimi i një fondi emergjent në nivel vendi dhe në nivelin lokal; • Hartimi i një ligji për sigurime për kompensim të dëmeve nga fatkeqësitë; • Avancimet e teknologjisë së informimit dhe komunikimit; • Eksplorimi i metodave të tjera të sistemeve të paralajmërimit të hershëm; • Rritja e vullnetarizmit.

5. Korniza ligjore dhe mekanizmi institucional

5.1 Korniza ligjore

Strategjia për ZRRF bazohet në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe në Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore, (i aprovuar në vitin 2016, aktualisht në proces të rishikimit). Grupi punues ndërministror gjatë hartimit të kësaj strategjie ka konsultuar edhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, që ndërlidhen apo ngërthejnë në vete trajtimin apo rregullimin e fushës së ZRRF-së përfshirë, por duke mos u kufizuar me ligjet në vijim:

- Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Nr. 04/L-027;
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 2010/03-L-214;
- Ligji për Mbrojtje nga Zjarri, Nr. 2011/04-L-012;
- Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Nr. 04/L-049;
- Ligji për AME-në, Nr. 04/L-230;

- Ligji për Pajisjet nën Presion, Nr. 06/L-031;
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Nr. 03/L-049;
- Ligji për Inspektoratin e Punës, Nr. 2002/09;
- Ligji për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, Nr.2008/03-L050;
- Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Nr. 04/L-161;
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 2013/04-L-194;
- Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes, Nr. 06/L-122;
- Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës Nr.06/L-123;
- Ligji për Shëndetin Publik, Nr. 2007/02-L-78;
- Ligji për Shërbimin Shëndetësor Emergjent, Nr. 2006/02-L-50;
- Ligji për Kryqin e Kuq të Kosovës, Nr. 2010/03-L-179;
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 2008/03-L-040;
- Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr.2012/04-L-174;
- Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/l-188;
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110;
- Ligji për Pyjet e Kosovës. Nr. 2003/3;
- Ligji për Mjedisin Nr. 03/L-02;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 2004/24;
- Ligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës Nr.06/L-039 2018;
- Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike Nr. 06/l -035, 2018;
- Ligji për Veterinarinë Nr.2004/21;
- Ligji i Ushqimit Nr. 08-L-120;
- Ligji për Përkujdesje ndaj Kafshëve Nr. 02-L-10;
- Ligji për Mbrojtjen e Bimëve 04-L- 120;
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse Nr. 03-L-109;
- Ligji për Rezervat Shtetërore të Mallrave Nr.03 /L-244;
- Ligji për Aviacionin Civil 03/L-051;

- Ligji për Lirinë e Asocimit për OJQ -të 06/L-043;
- Ligji për Energji 05/L-081;
- Ligji për Energji Elektrike 05/L-085;
- Ligji për Policinë Nr.04/L-076;
- Ligji për Statistika Zyrtare 04/L-036;
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

Strategjia kontribuon drejtpërdrejtë në menaxhim të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si pjesë e Planit të Qeverisë në veçanti në objektivin“ Kryerja e studimeve të veçanta me qëllim të zvogëlimit, parandalimit, mbrojtjes, reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore”.

Do të vazhdohet me politikat ekzistuese:

- Hartimin e politikave, rishikimin dhe plotësimin e ligjeve për zvogëlimin e rrezikut;
- Hartimin e Planit Shtetëror për Zvogëlimin e Rrezikut;
- Hartimin e Planit Shtetëror për Parandalimin e Fatkeqësive;
- Hartimin e Planit Shtetëror të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë;
- Ngritjen e kapaciteteve për zvogëlimin e rreziqeve;
- Vazhdimin e bashkëpunimit me Programin IPA/ Komisioni Evropian për ngritjen e kapaciteteve;
- Themelimin e Qendrës (QOMP) Kombëtare për Menaxhimin e Situatave Emergjente;
- Zhvillimin e programit të ushtrimeve dhe vlerësimit të gatishmërisë emergjente në fushën e sigurisë së përgjithshme publike;
- Hartimin e Planit Shtetëror për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë.

5.2 Mekanizmat institucional

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në Kosovë.

Mekanizmat institucional për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë janë, por nuk kufizohen vetëm në këto institucione:

5.3.1 Koordinatorin Nacional

Koordinatorin Nacional për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë është ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ose njëri nga zëvendës ministrat e autorizuar nga ai, i cili është përgjegjës të bashkërendoj, udhëzoj, monitoroj dhe të raportoj për zbatimin e politikave dhe aktiviteteve dhe veprimeve në lidhje me Strategjinë Shtetërore dhe Planin e Veprimit 2023-2025.

5.3.2 Sekretariati i Strategjive

Sekretariati i Strategjive në MPB, ka për detyrë të monitorojë në baza të rregullta zbatimin e strategjisë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna rreth zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, si dhe duke hartuar raportet periodike dhe vlerësuese për Koordinatorin Nacional. Përveç këtyre, Sekretariati do të ndihmojë Koordinatorin Nacional për koordinimin e strategjisë dhe komunikimin me palët e interesit.

5.3.3 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Bazuar në misionin dhe detyrat e MPB-së, që është të kujdeset për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Përmes mekanizmave dhe agjencive të saj, MPB-ja ndërmerr aktivitetet në zvogëlimin e rreziqeve në fatkeqësitë.

5.3.3.1 Agjencia e Menaxhimit Emergjent/AME

Misioni i Agjencisë është mbështetja e qytetarëve dhe reaguesve të parë për të siguruar që të punojnë si një trup, me qëllim të zhvillimit, mbajtjes dhe avancimit të kapacitetit tonë për tu përgatitur, mbrojtur, reaguar dhe rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet e mundshme, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri.

Cikli i kohëzgjatjes së fatkeqësisë nënkupton procesin përmes të cilit menaxherët emergjent përgatiten për emergjenca dhe fatkeqësi, reagojnë ndaj tyre kur ndodhin, ndihmojnë njerëzit dhe institucionet të rimëkëmben shpejt nga ato, zbusin efektet e dëmshme të tyre, zvogëlojnë rrezikun e humbjeve dhe parandalojnë ndodhjen e fatkeqësive të ardhshme.

5.3.3.2 Policia e Kosovës

Si agjenci e zbatimit të ligjit në kuadër të MPB-së, PK ka përgjegjësinë në zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, duke u mbështetur në të gjitha strukturat mbështetëse në kuadër të Policisë së Kosovës.

5.3.4 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)

MFPT do të ketë rol aktiv dhe bashkëpunues me të gjitha institucionet e ndikuara nga Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë, duke u përkujdesur që aktivitetet dhe objektivat e parapara të realizohen brenda ndarjeve të rregullta buxhetore.

5.3.5 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

Roli i MMPHI bazuar në misionin dhe detyrat, padyshim se ka përgjegjësinë në realizimin e objektivave dhe masave të caktuara në SZRRF me rolin e saj mbikëqyrës dhe pjesëmarrjen aktive në monitorimin e strategjisë.

MMPHI përmes SZRRF synon të zhvilloj politika integruese të shumë sektorëve të ndryshëm me qëllim të krijimit të kushteve për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit nga FNFT në fushën e rrezatimit radioaktiv, ndërtimit, ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, matjet e të reshurave atmosferike, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, paralajmërimi i paraqitjes së fatkeqësive elementare hidrometeorologjike, zgjidhjen teknike profesionale, zhvillimore dhe organizative për mirëmbajtjen, ndërtimin, rekonstruimin dhe sigurinë e hekurudhave, autostradës, rrugëve nacionale dhe rajonale, trafikut ajror, si dhe ofron mbështetje shkencore dhe profesionale për politikën mjedisore të vendit, ndërsa për qëllim të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë grumbullon të dhëna mbi trafikun dhe sigurinë, këshillon dhe njofton institucionet dhe qytetarët mbi gjendjen e rrjetit rrugor, hekurudhor dhe ajror, si dhe faktorët që ndikojnë në rrjetin e komunikacionit.

5.3.6 Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)

Roli i MM/FSK në implementimin e SZRRF përfshin tërë ciklin e menaxhimit të emergjencave, por objektiv primar i këtij institucioni është përcaktuar faza e gatishmërisë dhe reagimit, që të kryej operacione në rastet e fatkeqësive në Kosovë dhe jashtë saj. Operacionet e zhvilluara nga MM/FSK janë kryesisht operacionet e mbrojtjes kur seriozisht kanoset jeta e civilëve brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe ndihma ndaj autoriteteve civile në reagim ndaj fatkeqësive. FSK ka rol të rëndësishëm në operacionet e kërkim shpëtimit, mënjanimit të mjeteve shpërthyes, kontrollit dhe pastrimit të materieve të rrezikshme, si dhe detyrat tjera të ndihmës humanitare. MM/FSK ofron trajnime të shumta për institucione të ndryshme shtetërore për të rritur aftësitë reaguese tek popullata në raste të ballafaqimit me fatkeqësitë. MM/FSK gjithashtu ofron edhe kampanja dhe ligjërata vetëdijesimi në shkollat e Republikës së Kosovës për vetëdijesimin e të rinjve mbi rrezikun nga mjetet shpërthyes dhe mjetet e tjera të rrezikshme.

5.3.7 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)

Roli i MPJ është promovimi dhe mbrojtja e politikave nacionale, kulturore e ekonomike të Kosovës në botë, zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal me interes të përbashkët, përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe që përfshijnë edhe lëmin e menaxhimit të emergjencave, duke kontribuar në zvogëlimin e rreziqeve, si dhe nxitjen e bashkëpunimit shkencor, tekniko-teknologjik, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira për ZRRF të vendeve përkatëse. Krijimin e kushteve për investime kapitale të mërgimtarëve në vendlindje me qëllim të zvogëlimin dhe parandalimit të rreziqeve nga fatkeqësitë.

Kjo ministri është subjekti kryesor kontaktues për komunikim në rast të kërkesës për dhënien apo pranimin e ndihmës për mbështetjen e vendit të goditur nga fatkeqësitë por edhe për bashkëpunim ndërkombëtar në aktivitetet e tjera në lëmin e menaxhimit emergjent.

5.3.8 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Roli i MASHTI, në harmoni me prioritetet kombëtare për zhvillim, është të siguroj një sistem cilësor të arsimit, që garanton sigurinë dhe mbrojtjen e nxënësve dhe stafit shkollor. Kjo do të realizohet duke krijuar mjedise të sigurta shkollore sipas parametrave dhe standardeve të nevojshme për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë. Duke përfshirë në kurrikulum përmbajtje që vetëdijësojnë dhe aftësojnë nxënësit dhe të rinjtë në parandalimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësitë. MASHTI do të ketë rol të shtuar në përmbushjen e objektivave të SZRRF-së përmes ndërtimit të kapaciteteve në nivel qendror, lokal dhe shkollor në përgatitjen për parandalimin, reagimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë. Gjithashtu, MASHTI në bashkëpunim dhe bashkërendim me akterët dhe institucionet tjera, do të inkurajoj dhe përkrah stërvitjet dhe ushtrimet me simulimet e ndryshme që ndihmojnë nxënësit, të rinjtë, mësimdhënësit, stafin shkollor, por edhe prindërit dhe komunitetin të krijojnë aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme për t'u ballafaquar me situata të ndryshme të fatkeqësive. Kjo do të sigurojë një mjedis shkollor të sigurt, të shëndoshë e të qëndrueshëm.

5.3.9 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR)

Masat të cilat duhet të ndërmer MBPZhR për arritjen e objektivave të SZRRF gjenden në politikën për të ndihmuar administrimin dhe menaxhimin e sektorit të pylltarisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen, aktivitetet e ripyllëzimit, vetmbajtjen, parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, dezinfektimin kundër insekteve dhe sëmundjeve të ndryshme, licencimin për prerjen e druve, kontrollimin e gjuetisë dhe peshkimit, ofron shërbime veterinare, duke përfshirë ndër të tjera parandalimin e sëmundjeve të kafshëve, të zoonozës dhe përmirësimin e cilësisë së kopeve dhe tufave të shpezëve kurse në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyr zbatimin e standardeve shëndetësore që ndërlidhen me bujqësinë, pylltarinë, zhvillimin rural, qendrat për rritjen e peshqve,

kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë.

5.3.10 Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)

Roli i kësaj Ministrie për ZRRF është shumëdimensional por po vëmë në pah disa nga funksionet që i takojnë kësaj ministrie në bazë të detyrave dhe përgjegjësi, si dhe specifikave që ka:

- Mbikëqyr zbatimin e strategjisë brenda fushëveprimit të vet në nivel qendror dhe lokal, i drejtohet komuniteteve për ndihmë, mbështet zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë në të gjitha komunat duke ndihmuar integrimin e politikave në planet zhvillimore duke e integruar zvogëlimin e rreziqeve në kushte të barabarta të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;
- Koordinon me ministrinë, komunat dhe autoritetet e tjera për zbatimin e SZRRF, gjithnjë bazuar në parimin e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes në fatkeqësi duke respektuar të drejtat themelore të njeriut, në mënyrë që të sigurojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve, duke iu kushtuar vëmendje të posaçme nevojave të grave, fëmijëve, personave të moshuar dhe grupeve të tjera të ndjeshme;
- Ndihmon në zhvillimin dhe në zbatimin e masave në fushën e informimit publik dhe të projekteve të tjera promovuese për ngritjen e vetëdijes publike përkthazi me të drejtat dhe interesat e komuniteteve e të pjesëtarëve të tyre për mbrojtje nga fatkeqësitë, si dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në bashkëpunim dhe inkurajim të sektorit privat dhe bizneset.

5.3.11 Ministria e Shëndetësisë (MSh)

Përcjell situatën e shëndetësisë dhe zbaton masat përkatëse për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë duke përkrahur pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me shëndetin. Merr pjesë në hartimin dhe zbatimin e parandalimit dhe zvogëlimit të rreziqeve nga epidemitë dhe sëmundjet e ndryshme. Kjo Ministri përmes fushatës për informim publik dhe projekteve të tjera promovuese rrit vetëdijesimin publik në pajtueshmëri me standardet shëndetësore, inkurajon zhvillimin e arsimit shëndetësor dhe të mjedisit për ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetit publik. Monitoron dhe konstaton gjendjen e shëndetit publik, në veçanti ndikimin e veprimtarive industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarive ekonomike, meqë ndërlidhen me mbrojtjen e shëndetit publik. Në bashkëpunim me ministrinë tjera përkatëse, identifikon fushat që duhet mbrojtur për shëndetin publik, krijon politikën e aktiviteteve në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent dhe implementimin e masave për ZRRF.

5.3.12 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS)

MKRS rolin e saj në SZRRF e ka në ndërmarrjen e masave dhe zhvillimin e aktiviteteve në ruajtjen, mbrojtjen dhe prezantimin, restaurimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore, trashëgimisë arkitekturore, trashëgimisë së luajtshme, trashëgimisë shpirtërore, konservimit të integruar dhe peizazheve kulturore, si dhe inventarizimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

5.3.13 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)

Siguron mbështetje të drejtpërdrejt teknike dhe këshilla në prokurimin e shërbimeve konsultative të jashtme për vlerësimin e sigurisë strukturore dhe nga zjarri, të ndërtesave dhe linjave jetësore (shërbimet publike).

Planifikon, deponon dhe mbikëqyr aktivitetet e rezervave shtetërore, në lidhje me zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë.

5.3.14 Ministria e Zhvillimit Rural (MZHR)

MZHR siguron zhvillim, implementim, monitorim, hartim dhe koordinim të programeve për zhvillim rajonal, zhvillimit socio-ekonomik, si dhe informim lidhur me masat e reja që kanë të bëjnë me zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë (ZRRFNFT).

5.3.15 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Roli i MAPL në SZRRF është mbështetja dhe avancimi i qeverisjes lokale në fuqizimin e strukturave për mbikëqyrjen e kësaj strategjie dhe sigurimin e zbatimit të aktiviteteve të planeve komunale për zvogëlimin e rreziqeve dhe përfshirjen e këtyre planeve në planet zhvillimore lokale.

5.3.16 Ministria e Ekonomisë (ME)

Roli i ME, përgatit dhe zbaton politika, të cilat nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas, nxisin bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja, garantojnë konkurrencën dhe një treg të sigurt, sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike e minerare të vendit, sigurojnë zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit dhe teknologjisë informative, si dhe garantojnë eficientë në administrimin e ndërmarrjeve publike, si dhe planifikojnë buxhetin për politikën, strategjitë, ligjet dhe planet për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë.

5.3.17 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh)

OSSH është përgjegjës që të operojë me rrjetin e shpërndarjes dhe ka ekskluzivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tërë territorin e Kosovës. Roli i OSSh-së është që të jep kontributin e saj në zbatimin e planeve të veprimit dhe detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, duke mbështetur të gjitha proceset me të gjitha kapacitetet që ka.

5.3.18 Kryqi i Kuq i Kosovës (KKK)

KKK është organizatë vullnetare e cila do të mbështes Strategjinë për Zvogëlimin e Rrezikut me të gjithë sektorët e vet, sidomos me sektorin e menaxhimit të fatkeqësive dhe atë të ndihmës së parë. Kjo organizatë vullnetare përmes kapaciteteve të veta në nivelin qendror dhe lokal, do të pjesë vitale e aktiviteteve për zvogëlimin e rreziqeve në aspektin e sensibilizimit, trajnimeve ushtrimeve, si dhe të mbështetjes së reagueseve të parë në vendin e incidentit.

6. Objektivat Strategjike për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë

6.1 Sfondi

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë ka për qëllim parandalimin e rrezikut të ri, zvogëlimin e rrezikut ekzistues, si dhe menaxhimin e rrezikut të mbetur e që të gjitha këto veprime, kontribuojnë në forcimin e qëndrueshmërisë dhe elasticitetit të komuniteteve dhe rrjedhimisht edhe në arritjen e zhvillimit shoqëror të qëndrueshëm.

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë nuk duhet të zbatohet në mënyrë të izoluar. Për të zbatuar zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, duhet të merren parasysh marrëveshjet dhe udhëzimet ndërkombëtare. Korniza UNISDR2 SENDAY për Veprim: 2015-2030 theksoi pikat e mëposhtme të veprimit strategjik përkatës, kundrejt të cilave duhet të maten aktivitetet e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, siç është zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë:

- 1) Të sigurohet që zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë të jetë një prioritet kombëtar dhe vendor me një bazë të fortë institucionale për zbatim;
- 2) Të identifikohen, vlerësohen dhe monitorohen rreziqet e fatkeqësive dhe të përmirësohet paralajmërimi i hershëm;
- 3) Të përdoren njohuritë, inovacionet dhe edukimi për të ndërtuar një kulturë sigurie dhe qëndrueshmërie në të gjitha nivelet;
- 4) Të zvogëlohen faktorët themelorë të rrezikut;
- 5) Të forcohet gatishmëria ndaj fatkeqësive për reagim efektiv në të gjitha nivelet.

Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë është i lidhur ngushtë me zhvillimin e qëndrueshëm. Projektet e zhvillimore duhet të informohen nga planifikimi dhe aktivitetet për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

6.2 Planet zhvillimore

Më shumë vëmendje do t'i kushtohet bërjes së zhvillimit më të ndjeshëm ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike (dhe globale) që do të kenë mbi burimet tokësore dhe ujore në veçanti, dhe se si menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë do të integrohet në planifikimin e zhvillimit. Pa planifikim të duhur do të kemi mungesa të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të cilat mund të ndikojnë shumë në zhvillimin afatgjatë të vendit. Zvogëlimi i

rrezikut nga fatkeqësitë ndikohet nga një sërë faktorësh siç janë: ndryshimet klimatike, ekonomike dhe zhvillimi vendor e rajonal, kapaciteti për të zbatuar planifikimin, si dhe vendi duhet të mendoj me kujdes dhe në mënyra të reja për zvogëlimi efektiv të rreziqeve nga fatkeqësitë. Menaxhimi i rrezikut dhe pasojave të fatkeqësive/ngjarjeve të mundshme katastrofike/incidenteve në linjë me qasjen strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, është detyrë e të gjithëve përmes një partneriteti në mes institucioneve vendore, sektorit privat, OJQ-ve dhe institucioneve ndërkombëtare.

6.3 Pesë objektivat e Strategjisë

6.3.1 Objektivi Strategjik 1

1) Integrimi i zvogëlimit të rrezikut në politika, ligje dhe akte nënligjore dhe politika zhvillimore

Integrimi i politikave zhvillimore, rishikimi dhe plotësimi i ligjeve, si dhe akteve nënligjore në nivel qendror dhe në nivel lokal duke marrë në konsideratë edhe rolin e sektorit privat dhe të shoqërisë civile, kërkon përfshirje shumëdimensionale dhe adekuate në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Kjo strategji mëton që politikat, ligjet, aktet nënligjore dhe planet zhvillimore të rishikohen dhe plotësohen, si dhe të shoqërohen me mekanizma monitorimi dhe me buxhet të mjaftueshëm.

Objektivat specifike:

- 1.1) Rishikimi i politikave zhvillimore për zvogëlimin efikas të rreziqeve nga fatkeqësitë;
- 1.2) Integrimi i Zvogëlimit të Rrezikut në ligje dhe akte nënligjore;
- 1.3) Integrimi ndërinstitucional i politikave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si dhe zbatimi i ligjshmërisë me qëllim të menaxhimit dhe qeverisjes së rreziqeve; dhe
- 1.4) Rritja e mbështetjes financiare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

6.3.2 Objektivi Strategjik 2

1) Fuqizimi i kapaciteteve për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë bazohet në kornizën SENDAY dhe përmes tri komponentëve, sipas kuptimit të rrezikut, sipas cenueshmërisë dhe duke pasur parasysh ndërtimin e kapaciteteve. Po ashtu, duhet pasur kujdes nga rreziqet e reja, prandaj duhet të zhvillohen dhe fuqizohen kapacitetet humane dhe teknike, si dhe duhet investuar në bashkëpunim për ngritjen e kapaciteteve shkencore dhe në sisteme që prodhojnë informata të nevojshme paralajmëruese, të regjistruara, hulumtuara, parashikuara, analizuara dhe modeluara për fatkeqësitë që mund t'i kanosen vendit.

Objektivat specifike:

- 1.1) Fuqizimi i kapaciteteve për ZRRF, përmes njohjes së rrezikut dhe cenueshmërisë;
- 1.2) Rritja e aftësive për mirëmbajtje të infrastrukturës, modernizimi dhe digjitalizimi, për ZRRF;
- 1.3) Ngritja dhe zhvillimi i sistemeve për zvogëlimin efikas të rreziqeve nga fatkeqësitë; dhe
- 1.4) Krijimi i komuniteteve të sigurta dhe të qëndrueshme nga fatkeqësitë.

6.3.3 Objektivi Strategjik 3

1) Rritja e ndërgjegjësimit për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Ky objektivi strategjik ka për qëllim promovimin e aktiviteteve të ndryshme të cilat do të ndërgjegjësojnë dhe përgatisin komunitetet për tu përballur me sukses me të gjitha llojet e rreziqeve. Qëndrueshmëria e komuniteteve do të arrihet përmes edukimit, sensibilizimit dhe vetëdijësimit me qëllim të përfitimit të aftësive dhe shkathtësive për zvogëlimin dhe menaxhimin e rrezikut.

Objektivat specifike:

- 1.1) Rritja e ndërgjegjësimit për ZRRF përmes shkëmbimit të informacionit, partneriteteve strategjike, edukimit dhe trajnimit; dhe
- 1.2) Promovimi dhe zhvillimi i instrumenteve dhe programeve që hartojnë standarde, kode, udhëzime operative, plane, projekte, etj.

6.3.4 Objektivi Strategjik 4

1) Fuqizimi i mekanizmave të menaxhimit të informacionit dhe bazës së të dhënave

Fuqizimi i mekanizmave të menaxhimit të informacionit do të arrihet përmes përmirësimit të komunikimit, koordinimit, grumbullimit dhe shpërndarjes së informacionit, në mes institucioneve përkatëse, nga një Qendër Kombëtare Fuzionuese, e që do të ndikojë fuqishëm në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Objektivat specifike:

- 1.1) Përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në mes të institucioneve; dhe
- 1.2) Forcimi dhe zbatimi i njohurive për menaxhimin e informacionit dhe teknologjisë për ZRRF në të gjithë sektorët.

6.3.5. Objektivi Strategjik 5

1) Gatishmëria dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Ky objektivi do të arrihet përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve dhe shkallës së rrezikshmërisë. Do të hartohen Plane Operative Emergjente, Plane Kontingjente, do të organizohen trajnime dhe certifikime, si dhe do të hartohet Programi dhe Planet për Ushtrime dhe Vlerësim të Gatishmërisë.

Objektivat specifike:

- 1.1) Identifikimi i rreziqeve dhe shakatarëve të tyre;
- 1.2) Vlerësimi dhe analiza e rreziqeve;
- 1.3) Inspektimi i rreziqeve;
- 1.4) Monitorimi i rreziqeve;
- 1.5) Menaxhimi i mjedisit dhe përshtatja ndaj ZRRF; dhe
- 1.6) Forcimi i gatishmërisë ndaj fatkeqësive për reagim efektiv në të gjitha nivelet.

7. Marrëveshjet për kapacitete të integruara institucionale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Në vitin 2005, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rezoluta A/RES/59/231: u bëri thirrje qeverive të krijojnë platforma kombëtare ose pika qendrore për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, inkurajoi qeveritë të forconin platformat aty ku ato ekzistojnë dhe i kërkoi sistemit të Kombeve të Bashkuara të ofronë mbështetjen e duhur ndaj atyre mekanizmave, ku objektivat e një platforme kombëtare u identifikuan si:

- Rritja e udhëheqjes kombëtare dhe angazhimit për qëndrueshmërinë e zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë dhe zbatimin e Kornizës Hyogo dhe Senday;
- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve kombëtarë me qëllim rritjen e niveleve të njohurive dhe aftësive për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;
- Rritja e angazhimit kombëtar për të ndihmuar popullatën më të cënueshme dhe më të rrezikuar;
- Të shërbejnë si pika qendrore kombëtare në sistemin UNISDR dhe të forcojnë lidhjet me sekretariatit dhe Task Forcën e UNISDR.

Baza institucionale për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, megjithatë, nuk duhet të varet vetëm nga strukturat dhe iniciativat kombëtare. Në fakt, siç u përmend më lart, zvogëlimi efektiv i rrezikut nga fatkeqësitë duhet të jetë një qasje nga poshtë-lart dhe jo nga lart-poshtë.

Figurat e mëposhtme ilustrojnë nivelet institucionale dhe rregullimet për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend dhe theksojnë rëndësinë strategjike të nivelit lokal dhe komuniteteve në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Figura e parë tregon nivelet strategjike në të cilat do të zbatohet zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në vend, dhe figura e dytë tregon përgjegjësitë, inputet dhe integrimin ndërmjet palëve të interesuara në lidhje me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Fig:1

NIVELI STRATEGJIK
Qeveria, MPB-Ministritë dhe institucionet tjera
Politikat, strategjitë, ligjet, udhëzuesit, ngritja e kapaciteteve, monitorimi dhe vlerësimi, bashkëpunimi dhe integrimi ndërqeveritar, ndër sektorial dhe ndërkufitar.

Fig:2

NIVELI OPERACIONAL
Institucionet ekzekutive, niveli lokal, drejtoritë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Komunitetet dhe OJQ-të
Politikat, strategjitë, ligjet, udhëzuesit, ngritja e kapaciteteve, monitorimi dhe vlerësimi, bashkëpunimi dhe integrimi ndërqeveritar, ndër sektorial dhe ndërkufitar.

Figura 1 dhe 2: Nivelet ku zbatohet zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë në vend.

8. Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2023-2025

Mekanizmi i monitorimit do të korrespondojë me parimet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në Doracakun për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Tyre të Veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Zvogëlim të Rreziqeve për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera 2023-2028 dhe për ndërmarrjen e veprimeve, nëse është e nevojshme, për të siguruar zbatimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve të zbatimit. Autoriteti përgjegjës për përgatitjen e raporteve sipas mandatit është Sekretariati për Strategjitë i cili funksionon në kuadër të MPB-së.

8.1 Direktivat e zbatimit strategjik dhe prioritetet për ndryshimin strategjik

Direktivat e mëposhtme strategjike për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, që do të zbatohen për pesë vitet e ardhshme:

- Parimet e bashkëpunimit, komunikimit efektiv dhe menaxhimit të informacionit, raportimit dhe harmonizimit (standartet e përbashkëta të praktikës) të planifikimit dhe zbatimit për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, do të respektohen gjatë gjithë kohës nga të gjitha institucionet, palët e interesuara dhe lojtarët me role.
- Trajnimet, ngritja e kapaciteteve dhe kërkimi mbi menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë do të kryhen vazhdimisht nga të gjitha institucionet, palët e interesuara dhe lojtarët me role.
- Përfshirja dhe bashkëpunimi i lojtarëve dhe specialistëve të roleve joqeveritare, si dhe përfshirja e informacionit dhe njohurive historike dhe vendase të rëndësishme për rreziqet e fatkeqësive, do të sigurohen nga të gjitha institucionet, palët e interesuara dhe lojtarët me role.
- Të gjitha institucionet, palët e interesuara dhe akterët do të kryejnë kërkime të detajuara, të marrin të gjitha këshillat dhe inputet e nevojshme teknike dhe të drejtojnë dhe monitorojnë zbatimin e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, përmes bashkëpunimit, komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit në mënyrë konstante.
- Bashkëpunimi dhe integrimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar do të sigurohet më tej nga të gjitha institucionet, palët e interesuara dhe lojtarët me role.
- Shteti do të jetë përgjegjës për të udhëhequr dhe monitoruar zbatimin e këtyre direktivave dhe për të zbatuar funksionet e veta legjislative ose të caktuara brenda vendit, por planifikimi dhe zbatimi i detajuar i zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë duhet të ekzekutohet nga të gjitha institucionet, palët e interesuara dhe lojtarët me role.
- Planifikimi i zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe zvogëlimi i rrezikut është përgjegjësi e të gjitha institucioneve, palëve të interesuara dhe akterëve në vend, duke punuar me zyrtarët e menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, por reagimi ndaj fatkeqësive, rimëkëmbja dhe rehabilitimi mbetet përgjegjësia kryesore e institucionit që ka pronësinë dhe/ose legjislativin ose i caktohet përgjegjësia mbi zonën dhe/ose asetet e prekura nga një incident i mundshëm katastrofik, duke punuar me të gjitha institucionet përkatëse, palët e interesuara dhe lojtarët e roleve, pavarësisht nëse është shpallur apo jo një gjendje fatkeqësie.

8.2 Direktivat e zbatimit strategjik dhe prioritetet për ndryshimin strategjik

Procesi i implementimit të strategjisë do të synoj përbushjen e objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të objektivave dhe aktiviteteve do të jetë pjesë përbërëse e procesit të strategjisë, si dhe kyçe në përbushjen e saj.

Përmes monitorimit do të bëhet mbledhja e vazhdueshme dhe sistematike e të dhënave për matjen e progresit dhe zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Vlerësimi do të bëhet në baza të rregullta periodike, çdo 1 vit por edhe ad-hoc, përmes së cilit do të vlerësohet zbatuesmëria e Planit të Veprimit, ndikimit në praktikë. Procesi i vlerësimit do të rezultojë me ne rishikimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit, duke siguruar planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për zbatimin efektiv të objektivave strategjik dhe harmonizimin me trendët e rreziqeve vendore, rajonale dhe globale.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe të vlerësimit të Planit të Veprimit të Strategjisë janë:

- Kapaciteti institucional;
- Indikatorët e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës tre vjeçare;
- Burimet e informimit dhe instrumentet e matjes.

8.3 Kapaciteti institucional për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të zgjerohet për të mbuluar të gjitha institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuar në Strategji dhe Plan të Veprimit.

Çdo palë e interesit duhet të identifikojë rolin e vet në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë si pjesë e menaxhimit të tij të rrezikut nga fatkeqësitë dhe planifikimit të zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë. Të gjithë sektorët dhe ministritë duhet të përfshijnë zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë në proceset e tyre vjetore të planifikimit strategjik:

- Koordinatori Nacional për ZRRF, si institucion udhëheqës për koordinimin e përbushjes së objektivave, do të monitoroj indikatorët e Strategjisë për ZRRF;
- Sekretariati i Strategjive do të monitoroj në baza të rregullta zbatimin e Planit të Veprimit, duke mbledhur raporte tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, vjetore dhe raporte ad-hoc nga të gjitha institucionet përkatëse dhe do të hartoj raporte analitike të zbatimit të strategjisë sipas nevojës;
- Ministritë, organet zbatuese dhe institucionet tjera me detyra në Plan të Veprimit do të jenë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që u janë ndarë atyre apo institucioneve vartëse të tyre. Këto institucione do të dorëzojnë raportet e tyre tremujore, gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore tek Sekretariati i Strategjive.
- Organizata joqeveritare dhe sektori privat duhet të kyçen në raportim.
- Organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare do të marrin pjesë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë duke forcuar gjithë përfshirjen, transparencën dhe llogaridhënien.

8.4 Indikatorët për monitorim dhe vlerësim

Secili aktivitet në kuadër të Planit të Veprimit ka indikatorët përkatës kualitativ dhe kuantitativ që do të shërbejnë gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit.

8.5 Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

- Të dhënat administrative/ statistikore nga akterët e ndryshëm përkatës;
- Raporti vjetor i zbatimit të strategjisë dhe raportet tjera ad-hoc;
- Raportet e jashtme nga sektori privat, OJQ- vendore dhe ndërkombëtare si, dhe
- Anketat e ndryshme.

9. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit i kësaj Strategjie është në përputhje me politikat shtetërore për ZRRF dhe në harmoni të plotë me kornizën e Strategjisë Shtetërore për ZRRF.

Plani i Veprimit do të rishikohet në fund të çdo viti në mënyrë që të sigurohet zbatimi i Strategjisë dhe harmonizimi me trendët e Kornizës Ndërkombëtare SENDAY, për ZRRF në nivelin global.

Plani i Veprimit për zbatimin e kësaj strategjie përfshin:

- Objektivat strategjik;
- Objektivat specifik;
- Aktivitetet konkrete për implementim;
- Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për përmbushjen e secilit objektiv;
- Specifikimin e kornizës kohore për përmbushjen e secilit aktivitet;
- Përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
- Përcaktimin e indikatorëve për implementimin e secilit objektiv dhe aktivitet, dhe
- Shtojcën e aktivitete të përgjithshme për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë për kategori të veçanta të rrezikut.

Plani i Veprimit është dokument i brendshëm dhe me shpërndarje të kufizuar.